



BASHKIA MIRDITË

BULETINI I MUAJIT JANAR

31.01.2025

Çështjet kryesore:

- Situata e krijuar nga reshjet e bores dhe infrastruktura rrugore.
- Proçesi i rindërtimit për banesat individuale në truallin ekzistues.
- Emërohet Sekretari i Përgjithshëm.
- Policia Bashkiake
- Vendimet e miratura nga Këshilli Bashkiak Mirditë.
- Cool-Crafting.
- Komedia "Darka e të marrëve".
- Promovimi i librit të autorit Alfred Duka "Bija e Pangjesë".

Buletini mujor i Bashkisë Mirditë ka për qëllim informimin e qytetarëve mbi aktivitetet, projektet dhe iniciativat që realizohen në nivel lokal, në përputhje me parimet e vetëqeverisjes vendore.

Ky buletin ofron një pasqyrim të përditësimeve dhe zhvillimeve më të fundit, duke siguruar një komunikim të hapur dhe transparent me qytetarët.

Përmes këtij buletini, synojmë të inkurajojmë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset e vendim-marrjes dhe të krijojmë një lidhje më efektive mes administratës lokale dhe qytetarëve.



SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Është emëruar Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Mirditë, Z. Artur Lazri. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i bashkisë Mirditë. Bazuar dhe në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të bashkisë Mirditë, Sekretari i Përgjithshëm ka përgjegjësinë për menaxhimin dhe koordinimin e administratës që aktivitetet e bashkisë të zhvillohen në mënyrë efikase dhe të rregullt.

Situata e krijuar nga reshjet e borës.



Në datat 11-12 janar 2025, kushtet atmosferike të paqëndrueshme dhe reshjet e dëborës shkaktuan bllokimin e rrugëve në zonat malore dhe vështirësi në qarkullim.

Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, në bashkëpunim me strukturën e Emergjencave Civile, kanë punuar intensivisht për zhblokimin e rrugëve dhe hedhje të kripës.



Infrastruktura rrugore.

Agjencia e Puneve Publike dhe Mirëmbajtjes vijon punën për përmirësimin e Infrastrukturës rrugore.

Në lulishten pranë ish- Gjykatës në Rrëshen janë liruar hapësirat publike që ishin zënë më parë, ndërsa janë sistemuar trotuaret dhe janë vendosur stola pushimi për qytetarët.



Asfaltimi i rrugës së Jezullit

Kanë filluar punimet për sistemin dhe asfaltimin e rrugës së fshatit Jezull, një projekt i cili do të përmirësojë dukshëm infrastrukturën e zonës.

Ky aks rrugor ka një gjatësi prej 1513 metrash dhe pritet të lehtësojë qarkullimin e banorëve dhe vizitorëve, duke mundësuar lidhje më të shpejta dhe të sigurta.



Proçesi i rindërtimit për banesat individuale në truallt ekzistuese në Mirditë.

Kryetari i Bashkisë Mirditë z. Albert Melyshi me datë 16.01.2025 mbledhi në një takim familjet e prekura nga tërmeti i vitit 2019, të cilët përfitojnë banesa në truallin ekzistues. Në këtë takim u komunikua vendimi i marrë nga qeveria në dhjetor 2024 që hap tashmë rrugën e vijimit të procesit të rindërtimit.

Në listë janë 51 familje gjithsej, ku 8 prej tyre janë për përfundim të banesës aktuale, ndërsa 43 familje të tjera do ju ndërtohen banesa në truallin ekzistues.



Policia Bashkiake Mirditë.

Policia Bashkiake është e angazhuar për të siguruar rendin, qetësinë dhe sigurinë në komunitet, si dhe mbarëvajtjen e punëve publike, miradministrimin e hapësirave publike dhe mbrojtjen e mjedisit.

Le të respektojmë rregullat dhe ligjet në fuqi.

Në këtë mënyrë ne kontribuojmë në krijimin e një shoqërie të sigurt dhe të rregullt. Në rast të moszbatimit të këtyre rregullave do të vendosen masa administrative

- ◆ Moszbatimi i rregullave të qarkullimit rrugor .
- ◆ Shkeljet të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
- ◆ Dëmtime dhe ndërhyrje në hapësirat e gjelbërta dhe ato publike.
- ◆ Dëmtime dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore.
- ◆ Mospajisje me leje për tregtim apo shërbim jashtë sipërfaqes së njësisive, për kryerjen e aktivitetit tregtar pa licencë, autorizim apo leje të tjera të ngjashme.
- ◆ Ndërhyrje dhe dëmtime në rrjetin elektrik rrugor.
- ◆ Dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza.
- ◆ Dëmtime dhe vjedhje të grumbulluesve të mbeturinave.
- ◆ Shkeljet në organizimin e eventeve dhe tubimeve.
- ◆ Zhurmat dhe ndotja akustike..
- ◆ Shkelje të rregullave të transportit publik..

**“Bashkëpunimi
juaj është
thelbësor për
mirëqenien e
përgjithshme dhe
zhvillimin e
qëndrueshëm të
komunitetit.”**



Për më shumë informacion mbi masat e parashikuara për shkeljet administrative e gjeni në Paketën Fiskale të Bashkisë Mirditë, të publikuar në faqen zyrtare web:
www.bashkaimirdite.gov.al

PROJEKT-VENDIMET E MIRATUARA NGA KËSHILLI BASHKIAK MIRDITË PËR MUAJIN JANAR

Këshilli Bashkiak Mirditë ka zhvilluar mbledhjen e radhës me datë 24.01.2025, ku u miratuan projekt-vendimet:

“Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në 6%, për periudhën 01 - 31 Dhjetor 2024”, bashkia Mirditë

“Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën me fondin e bashkisë, për periudhën 01 - 31 Dhjetor 2024”, bashkia Mirditë

-“Për miratimin e sasisë së konsumit të karburantit për automjetet, drejtoritë, agjencitë dhe njësitë administrative të bashkisë Mirditë”

“Për miratim fondi për shpenzimet telefonike”, bashkia Mirditë

“Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë

“Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë

“Për miratimin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e Z. Benjamin Geg GJOKA, qyteti Rrëshen, njësia administrative Rrëshen, bashkia Mirditë dhe përdorim fondi mbrojtjes civile”

“Për miratimin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e Z. Edmond Pjetër GJKO-LAJ, qyteti Rrëshen, njësia administrative Rrëshen, bashkia Mirditë dhe përdorim fondi mbrojtjes civile”

“Për miratimin e marrëveshjes së partneritetit lidhur ndërmjet; bashkisë Mirditë e përfaqësuar nga kryetari Z.Albert Mëlyshi në kuadër të programit IPA Interreg VI-B IPA Adriatic Ionian Programme (IPA ADRION)”

“Për miratimin e pagesës së qirasë për një periudhë 1 (një) vjeçare, sipas vlerës së tregut, për familjet e pastrehë”, bashkia Mirditë.

“Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e subvencionimit të qirasë”, bashkia Mirditë.

Për miratimin e pagesës së plotë për të dhënat e qirasë mesatare, në tregun e banesave për Qarkun Lezhë, sipas shkresës nr. 22412 prot, datë 06.12.2019”, bashkia Mirditë.

“Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese për programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara..

Për miratimin e hapjes së rrugës së re automobilistike që fillon nga varrezat e fshatit Petoq deri në lagjen Skortull të fshatit Petoq, Nj.Adm Fan.



Cool - Crafting

COOL -Crafting është një projekt që do të zbatohet në Mirditë nga Help Albania.

Ky projekt ka për qëllim krijimin e mundësive dhe lidhjeve optimale midis zejeve tradicionale dhe turizmit në Mirditë” .

Projekti do të përfshijë : Trajnime praktike dhe formim profesional për të rinjtë dhe grate, promovim të produkteve artizanale, si dhe rrjetëzim me turizmin.



Për kë është COOL Crafting?

1

Artizanët e Mirditës

Për ata që duan të ruajnë traditën dhe të zgjerojnë mundësitë

2

Gratë dhe të rinjtë (18–29 vjeç)

Për ata që kërkojnë aftësi dhe mundësi të reja punësimi

3

Operatorët turistikë dhe partnerët kulturorë

Për ata që duan të ofrojnë përvoja autentike për vizitorët.

Komedia “Darka e të marrëve”

Komedia franceze “*Darka e të Marrëve*” e shkruar nga Francis Veber, u shfaq në Pallatin e Kulturës Rrëshen. Shfaqja, e cila tregon historinë e një grupi miqsh që organizojnë një darkë ku secili sjell një person “të çmendur” për ta tallur, solli situata komike dhe mesazhe të thella mbi marrëdhëniet njerëzore dhe paragjykimet.

Me regji të Alket Bushit dhe interpretim nga aktorët Mario Paloka, Mark Hilaj, Alesia Alcani, Gerald Ndreca, Megi Coku dhe Fioraldo Alcani, komedia u prit mjaft mirë nga publiku, i cili shijoi një shfaqje plot humor dhe emocione.

Mesazhi kryesor i komedisë ishte nevoja për rikthim tek vetvetja dhe pranimi i të tjerëve pa paragjykimë duke nxitur reflektime mbi natyrën e marrëdhënieve njerëzore.




Promovimi i librit “Bija e Pangjesë”

Më datë 24 janar 2025, në QKF Mirditë, u promovua libri i autorit Alfred Duka, “Bija e Pangjesë”. Ky promovim tërhoqi vëmendjen e shumë dashamirësve të letërsisë. Libri është një reflektim i thellë mbi periudhën komuniste, një kohë që ka lënë gjurmë të thella në jetën e autorit mirditor dhe shoqërisë shqiptare.

Duke përfshirë tregime dhe novela, Duka na rrëfen për sfidat dhe vështirësitë e jetës nën regjimin e diktaturës, duke krijuar një pasqyrë të jetës në ato vite të errëta. Përmes stilit të tij, Duka i fton lexuesit të kalojnë përmes emocioneve dhe situatave të ngarkuara me dhimbje dhe rezistencë, duke theksuar përpjekjet për të ruajtur dinjitetin dhe shpresën edhe në kushte të vështira

Bija e Pangjese nuk është vetëm një libër, por një mësim i fuqishëm për të gjithë ne, që të mos harrojmë se sa e çmuar është liria dhe se sa shumë ka kushtuar ajo.



Faleminderit që shpëtove jetën time!

Nën sloganin “Faleminderit që shpëtove jetën time”, të organizuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, punonjësit e Bashkisë Mirditë u solidarizuan në një akt humanitar për të dhuruar gjak.

Dhurimi i gjakut është një akt i thjeshtë, por jetik.

Ai mund të shpëtojë jetën e një personi dhe të ndihmojë shumë të tjerë që kanë nevojë për trajtime mjekësore.



VOLEJBOLL

Me datë 26 janar 2025, Federata Shqiptare e Volejbollit, në bashkëpunim me KSSH Flamurtari, organizoi një aktivitet nderues për figurën e ish-volejbollistit dhe trajnerit të shquar vlonjat Ylli Lulushit.

Në këtë aktivitet zhvilluan një përballje sportive ekipet U18/F të Flamurtarit, Mirditës, Dinamos dhe Partizanit.

Ekipi i Flamurtarit kurorëzoi fitoren me vendin e parë ndërsa vendin e dytë e fitoi ekipi i Mirditës.



Shkurt 2025

E DIELË	E HËNË	MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	

Ditën e martë, datë 04.02.2025, ora 09:00 në ambientet e Njesisë Administrative Rubik, zhvillohet Konsultimi Publik nga Njësia e Menaxhimit të Projektit të Bankës Botërore (PIT) në varësi të Autoritetit Rrugor Shqiptar, mbi projekt-idenë “Ndërtimi i Urës Uzina Rubik” .

VISIT-MIRDITA

Visit- Mirdita është një website i krijuar nga Bashkia Mirditë për të mbështetur agro-turizmin vendas, zhvillimin ekonomik e social si dhe promovimin e Mirditës.

Nëse dëshironi të promovoni aktivitetin tuaj apo të jepni kontributin tuaj për përmirësimin e faqes na shkruani në:

info@visit-mirdita.com

www.visitmirdita.com



Kërkesë-Ankesë

Për çdo kërkesë – ankesë mund të drejtoheni pranë zyrave të bashkisë Mirditë ose nëpërmjet :

Adresës postare: Sheshi “Abat Doçi”, Godina e Re e Bashkisë Mirditë, 4601

Adresës Elektronike: info@bashkiamirdite.gov.al

bashkia@bashkiamirdite.gov.al

Na ndiqni dhe në rrjetet sociale!

Follow ➔ Bashkia Mirditë



www.bashkiamirdite.gov.al